

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

2025

Nr.Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Statusi i kërkesës	Tarifa
1.	06.01.2025	Redaksia “Nyje.al” Sa është numri i anëtarëve të pakicës rome dhe sa është numri i anëtarëve të pakicës egjiptiane që banojnë në bashkinë Kamëz? Sa është numri i të pastrehëve në Bashkinë Kamëz? Sa është numri i qytetarëve të pastrehë nga pakica Rome dhe nga pakica Egjiptiane që kanë aplikuar për strehim social pranë bashkisë Kamëz?	17.01.2025	Sipas studimit të bërë nga Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale të Bashkisë Kamëz janë regjistruar 329 familje rome dhe Egjiptiane me 1333 anëtarë. Në Bashkinë Kamëz kanë aplikuar 324 familje referuar programeve të strehimit social, të cilit 17 prej tyre janë pjesë e pakicës Rome dhe Egjiptiane. Familjet Egjiptiane që trajtohen me ndihmë ekonomike nga Sistemi Elektronik i Ndihmës Ekonomike janë 39 familje me 175 anëtarë , ndërsa pakicat Rome janë 7 familje me 36 anëtarë. - Familjet Egjiptiane që trajtohen me ndihmë ekonomike nga Fondi 6% I Bllok- Ndihmës Ekonomike janë 5 familje me 6 anëtarë ndërsa pakicat Rome nuk trajtohen aktualisht. - Familjet Egjiptiane që trajtohen me ndihmë ekonomike	Përfunduar	S’ka

				nga Fondi i Buxhetit të Bashkisë Kamëz janë 6 familje me 30 anëtarë ndërsa pakicat Rome 1 familje me 4 anëtarë.		
--	--	--	--	--	--	--

2.	06.01.2025	Redaksia “Nyje.al” Sa është numri i punëkërkesve që i përkasin pakicës Rome dhe pakicës Egjiptianetëregjistruar në zyrën e punës në qytetin e Kamzës përgjatë periudhës kohore janar 2024-janar 2025?	07.01.2025	Ju bëjmë me dijeni se Bashkia Kamëz nuk ka kompetencë për të dhënë përgjigje në lidhje me këtë çështje. Për këtë informacion, ju lutem drejtohuni Zyrës së Punës së Kamëz.	Përfunduar	S’ka
----	------------	---	------------	---	------------	------

3.	08.01.2025	Redaksia “Nyje.al” Cilat janë subjektet private dhe jo-private që ushtrojnë aktivitetin e tyre në hapësirat e Pallatit të Kulturës në Kamëz? Ju lutemi na listoni emrat e tyre, qofshin ato biznese apo institucione. 2- A kanë ato një marrëdhënie kontraktuale me Bashkinë Kamëz?	13.01.2025	Ju bëjmë më dije se aktualisht Bashkia Kamëz ka kontrata aktive qiradhënie në ambientet e Pallatit të Kulturës si vijon: Kontratën nr. 6608 prot., datë 21.07.2022, e rinovuar me nr. 6233 prot., datë 22.07.2024 me shoqërinë “Banka e Tiranës” SHA; Kontratën nr. 792 rep., datë 630 Kol, datë 01.04.2019 si dhe Kontratën nr. 7569 prot., datë 26.08.2022, e rinovuar me nr. 7075 prot., datë 26.08.2024 me shoqërinë “Skela Syla” SH.P.K Kontratën nr. 4110 prot., datë 10.05.2022 me shoqërinë “Intesa Sanpaolo Bank Albania” SHA;	Përfunduar	S’ka
----	------------	--	------------	--	------------	------

4.	08.01.2025	Redaksia “Nyje.al” Sa eshte buxheti për kulturën per vitin 2024 dhe si është shpërndarë ai? 2. Sa fonde janë dhënë për bibliotekën? 3. Me sa libra është pasuruar gjatë këtij viti, në formë blerjeje apo dhurate? 4. Sa frekuentim ka pasur biblioteka, sa aktivitete? 5. Sa buxhet është dhënë për aktivitete, koncerte apo forma të ngjashme të spektaklit? 6. Sa buxhet është dhënë për trashëgiminë kulturore materiale dhe jomateriale?	14.01.2025	Buxheti i alokuar për Kulturën për vitin 2024 është 11,301,000 lekë. Fonde për bibliotekën janë dhënë 594,025 lekë. Përgjatë vitit 2024 Biblioteka eshte pasuruar me 342 libra nga 24 dhurues. Biblioteka përgjate vitit 2024 është frekuentuar nga 716 lexues. Për aktivitete, koncerte apo forma të ngjashme të spektakleve është dhënë buxhet 1,450,000 lekë	Përfunduar	S’ka
----	------------	--	------------	--	------------	------

5.	10.01.2025	Znj. Erisa Kryeziu Cilat janë hapësirat që i banon dhe frekuenton administrata publike e Bashkisë Kamëz? 2. Sa është numri i punonjësve në secilën hapësirë që përdoret nga Bashkia Kamëz për administratën 3. Sa është numri i punonjësve të Bashkisë Kamëz në total? 4. Këto hapësira janë pronë publike e Bashkisë Kamëz apo janë me qira? 6. Kur do të nisë ndërtimi i godinës së re për Bashkinë Kamëz? A ka një projekt fitues? 7. Me çfarë financimesh do të ndërtohet ky projekt? Të vetë bashkisë apo me fonde të tjera mbështetëse? 8. Sa hapësira publike ka Bashkia Kamëz?	23.01.2025	Bashkia Kamëz aktualisht frekuenton dy ambiente që janë pronë publike e saj, përkatësisht një ambjent në Kamëz dhe një në Valias. Ambienti në Valias ndodhet në: Rruga “Mati”, nr. 1, Lagjja Valias me sipërfaqe 2183.4 m2. Numëri në total i punonjësve të Bashkisë Kamëz në total është 428. Projekt zbatimi i godinës së re të Bashkisë Kamëz është ende në fazë tenderimi. Në momentin e shpalljes së projektit fitues ai do të jetë i disponueshëm për publikun. Godina e re e Bashkisë Kamëz është parashikuar të ndërtohet nga Fondet e Bashkisë.	Përfunduar	S’ka
----	------------	---	------------	---	------------	------

6.	10.01.2025	Artan Rama A ka bashkia juaj një plan për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane? A ka caktuar bashkia njëvenddepozitim për mbetjet urbane, apo për tipologji të tjera mbetjesh? Sa është numri i stacioneve të transferimit të mbetjeve në bashkinë tuaj.	21.01.2025	Iu bëjmë me dije se Ndërmarrja e Pastrimit Kamëz, është një institucion në varësi të Bashkisë Kamëz e cila realizon menaxhimin e mbetjeve urbane në territorin e Bashkisë Kamëz. Për sa i përket informacionit të kërkuar nga ana juaj, iu informojmë si më poshtë, vijon: Ndërmarrja e Pastrimit Kamëz, në kuadër të realizimit të detyrave funksionale, është në proces përgatitje të Planit të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane, ku pas miratimit nga organi përfaqësues Kamëz, do t'iu vihet në dispozicion menjëherë në rrugë zyrtare.	Përfunduar	S'ka
----	------------	---	------------	--	------------	------

7.	22.01.2025	Ilda Koci gazetarja Qendra Faktoje Bashkia juaj e ka të përcaktuar se pas grumbullimit, transporti i mbetjeve do të kryhet drejt Landfillit të Sharrës në TiranëA ka pasur raste kur Landfilli i Sharrës ka refuzuar trajtimin e mbetjeve nga bashkia juaj, për shkak të mospagesave të kostos së përpunimit apo pamundësisë për përpunim? Si keni vepruar me mbetjet?	29.01.2025	Ju bëjmë me dije se institucioni ynë nuk ka administruar ndonjë informacion për problematikën e pretenduar nga ana juaj. Ndërmarrja e Pastrimit Kamëz nuk ka patur ndonjëherë problematika mbi refuzimin e trajtimit të mbetjeve në Zonën e Trajtimit të Mbetjeve Tiranë për shkaqet e referuara nga ana juaj.	Përfunduar	S'ka
----	------------	--	------------	---	------------	------

8.	24.01.2025	Artan Rama Meqënëse pohoni se po rishikoni planin kërkoj atëherë - një kopje të planit të vjetër; kërkoj të di kohën kur parashikoni të përfundoni draft-planin e ri të manaxhimit, si dhe kopje të një dokumenti zyrtar (urdhër apo vendim) që zyrtarizon çeljen zyrtare të procesit për hartimin e planit të ri të manaxhimit të integruar të mbetjeve. nëse keni stacione transferimi dhe ku ndodhen ato, përpara se mbetjet urbane të shkojnë në Sharrë.	28.01.2025	Ndërmarrja e Pastrimit Kamëz, që nga periudha Mars 2024 realizon vetë menaxhimin e mbetjeve urbane për territorin e Bashkisë Kamëz. Ndërmarrja e Pastrimit Kamëz, në kuadër të realizimit të detyrave funksionale, është në proces të rishikimit të Planit të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane, të Bashkisë Kamëz. Bashkia Kamëz ka akt-marrëveshje me Shoqërinë “INTEGRATED ENERGY BV SPV” e nënshkruar me ADMINISTRATORIN SHTETËROR, “Për depozitim të mbetjeve urbane në Zonën e Trajtimit të Mbetjeve Tiranë” sipas parashikimeve ligjore në fuqi. Mbetjet Urbane të Bashkisë Kamëz, depozitohen sipas akt-marrëveshjes së sipërcituar në Zonën e Trajtimit të Mbetjeve Tiranë që është dhe zona e përcaktuar për depozitim të mbetjeve urbane për Bashkitë e Qarkut Tiranë.	Përfunduar	S’ka
----	------------	--	------------	--	------------	------

9.	03.02.2025	Selma Daku “Nyje.al” A ka të parashikuar Bashkia Kamëz subvencionim të transportit publik për pensionistët që banojnë në qytetin e Kamzës? Nëse po, cili është plani dhe procedurat e parashikuara? Nëse nuk ka një plan të tillë, a ka hyrë Bashkia Kamëz në një proces diskutimi dhe hulumtimi rreth një politike lehtësuese në transportin publik për banorët pensionistë të qytetit? Cilat janë sfidat që nuk e kanë lejuar Bashkinë Kamëz ta marrë si nismë deri tani? Cilat janë alternativat ekzistuese që ofrohen për pensionistët për të lehtësuar qasjen në transportin publik? A ka bërë Bashkia Kamëz ndonjë hulumtim të nevojave të pensionistëve në lidhje me transportin publik, dhe si janë përdorur këto informacione në politikat e saj? A është në dijeni institucioni juaj në lidhje me ankesat dhe pakënaqësitë e përditëshme të pensionistëve që banojnë Kamzën.	12.02.2024	Bashkia Kamëz i kushton vëmendje dhe prioritet çdo ankesë ose problematikë që i adresohen. Gjatë procesit të dëgjimeve publike me qytetarët, subjektet dhe grupet e interesit për miratimin e buxhetit dhe paketës fiskale, nuk janë regjistruar ankesa apo kërkesa në lidhje me çështjen që keni paraqitur. Bashkia Kamëz ka si mision të garantojë shërbime komunitare të kujdesit shoqëror në përputhje me standartet kombëtare, për të përmirësuar jetën e çdo individi.	Përfunduar	S’ka
----	------------	--	------------	---	------------	------

10.	18.02.2025	Artan Rama Ju lutem na vini në dispozicion një kopje të Planit Rajonal për Zonën e Menaxhimit të Mbetjeve tuaj. vendosja e masave dhe realizimi i objektivave duhet të mbështet mbi planet rajonale, kështu që një plan u tilla ekziston dhe se duhet që patjetër të jeni mbështetur në të.	21.02.2025	Duke qenë se ju vetë e keni cituar më sipër, dhe duke marrë parasysh që Plani Rajonal për Zonën e Menaxhimit të Mbetjeve i përket Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, ju mund ti drejtoheni personalisht drejtëpërdrejtë këtij institucioni për vënien në dispozicion të një kopje të planit.	Përfunduar	S'ka
-----	------------	---	------------	---	------------	------

11.	21.02.2025	Ana Rrushi, studente e masterit ne Universitetin Teknik te Dortmundit ne Gjermani. informacion lidhur me linjat e transportit publik per sa i perket shtrirjes ne hapesire, nese ju zoteroni nje harte ku percaktohen rruget qe mjetet e transportit publikpershkrojne, do te ishte shume e dobishme per mua.	03.03.2025	Linja rrethqytetese,r rethrrrotullimi Bathore-Zall Herr- Plus "By Pass" Stacionet: Kamez, Rr. "Demokracia" , St.1- St.2 - St.3 - St.4 - St.5 - St.6 - Rr. "Zall- Herr" - St.7 - St.8 - St.9 - St.10 - Stacioni Fundor "Zall- Herr" - St.11 dhe kthim. Rrethrrrotullim i Bathore – Plus "By Pass" Stacionet: Kamez, Rr. "Demokracia" St.1 - St.2 - St.3 - St.4 - St.5 - St.6 - By Pass St.12 - Impjanti Bovilles Stacioni Fundor St.13 dhe kthim.	Përfunduar	S'ka
-----	------------	---	------------	---	------------	------

12.	26.02.2025	Artan Rama 1.Kopje të kontratës së Bashkisë me kompaninë koncensionare nënshkruar në maj 2018. 2. Bazuar në kontratën e koncensionit, mbi ç'pikë të saj u bë prishja e kontratës? 3. Një kopje të proces verbalit të dorëzimit.4. A u bë seleksionimi i mbetjeve urbane gjatë zbatimit të kontratës?	07.03.2025	Kontrata e Bashkisë Kamëz me kompaninë koncensionare , është lidhur me datë 25.05.2018 dhe është zgjidhur me kërkesë të Koncesionarit me datë 28.03.2024, për arsye se nuk është ndërtuar stacioni i transferimit. Kontrata është e publikuar pranë faqes zyrtare të Drejtorisë së Koncensioneve dhe Partneriteteve	Përfunduar	S'ka
-----	------------	---	------------	--	------------	------

13.	12.03.2025	Kostandina Këruti A keni ofruar mbështetje financiare për organizatat jofitimprurëse (OJF) gjatë vitit 2024? 2. Nëse keni ofruar mbështetje financiare, cila ka qenë forma e mbështetjes (grant, kontrata shërbimi, prokurim publik/tenderim, etj.)? 3. Sa OJF kanë aplikuar për mbështetje financiare gjatë vitit 2024? 4. Sa OJF kanë përfituar nga kjo mbështetje?	27.03.2025	Në këtë kuadër, në Gusht të vitit 2023, Bashkia Kamëz ka shpallur Thirrjen e Tretë Publike për mbështetjen e OJF-ve, me fokus në përfshirjen sociale, rininë dhe mjedisin, ku janë shpallur fituese 2 organizata jofitimprurëse. Disbursimet për implementimin e këtyre projekteve janë realizuar gjatë vitit 2024. Në thirrjen publike të projektit ReLOaD2 e hapur në Gusht të vitit 2023, kanë aplikuar 12 OJF dhe janë shpallur 2 OJF fituese https://kamza.gov.al/kamez-rezultate . Adresa elektronike e koordinatorit të konsultimit publik është: konsultimi.publik@kamza.gov.al	Përfunduar	S'ka
-----	------------	--	------------	--	------------	------

14.	19.03.2025	Znj. Era Sherifaj A ka pasur Bashkia juaj buxhet vjetor të planifikuar për rininë (grup moshën 15-29 vjeç) për periudhën janar - dhjetor 2024? Sa është numri total i punonjësve në Bashkinë tuaj (2024)? A ka Bashkia juaj politika rinore të zhvillura specifikisht për grup moshën 15-29 vjeç? A keni një plan veprimi për Këshillin Rinor Vendor (KVR)?	03.04.2025	Bashkia Kamëz ka pasur buxhet vjetor të planifikuar për rininë 10.778.333 lekë, ku 0.3% e shumës totale i përket këtij buxheti. Numri total i të punësuarve në Bashkinë Kamëz për vitin 2024 ka qënë 424 punonjes nga të cilët 203 punonjes ishin femra dhe 151 meshkuj. Punonjës me aftesi të kufizuar në Bashkinë Kamëz për vitin 2024 kanë qënë 7 punonjës nga të cilët 3 femra dhe 4 meshkuj.	Përfunduar	S'ka
-----	------------	---	------------	--	------------	------

15.	25.03.2025	Artan Rama Kërkoj të kem një kopje të proces verbalit të mbledhjes së mbajtur, ku, ndër të tjera, të pasyrohen: diskutimet e mbajtura, pyetjet e shtruara nga pjesëmarrësit dhe reagimet e përfaqësuesve të administratës.	04.04.2025	Të gjitha vendimet e miratuara nga Këshilli Bashkiak i gjeni të publikuara në faqen zyrtare të institucionit të Bashkisë Kamëz, në rubrikën e Këshillit Bashkiak. https://kamza.gov.al/vendimet/	Përfunduar	S'ka
-----	------------	---	------------	--	------------	------

16.	25.03.2025	Mirela Biba Kërkojmë regjistrimin e vajzës në çerdhe Lutem trajnoni stafin në komunikim me nënat të mos bëhen pengesë për edukimin e fëmijëve të tashmes tonë .	01.04.2025	Bashkia Kamëz gjatë këtij pesë vjeçari ka ndërtuar (6) gjashtë Çerdhe me të gjitha kushtet dhe standardet bashkëkohore, si dhe falë lehtësimit dhe thjeshtësimit të politikave sociale të Kryetarit për disa kategori të përcaktuara me VKB, ofrohet shërbim dhe ushqim falas.	Përfunduar	S'ka
-----	------------	---	------------	---	------------	------

17.	07.04.2025	Petrit Patushi Lutemi të shoqërise Agri Construction shpk, me adresë rruga e Dibrës, ish truproja e shkollës Skënderbej, Tiranë.	08.04.2025	Në zbatim të ligjit 9920 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë ", i ndryshuar. Bashkëlidhur gjeni Njoftim Detyrimin për subjektin tuaj.	Përfunduar	S'ka
-----	------------	--	------------	--	------------	------

18.	04.04.2025	Elsa Sula Numri total i dorëzuar nga qytetarër,organizat at pranë institucionittuaj? Numri i kërkesave që kanë marrë përgjigje brenda afateve ligjore? Numri i kërkesave të refuzuara?	09.04.2025	Numri total i ardhur nga ankuesit në Bashkinë Kamëz gjatë vitit 2023-2024 janë 90 ankesa. Të gjithë kërkesat e paraqitura nga ankuesit janë trajtuar dhe iu është dhënë përgjigje e plotë. Ashtu si dhe vet ligji për të drejtën e informimit e përcakton afati ligjor për kthimin e përgjigjeve është 10 ditë pune. Përgjatë vitit 20213-2024 nuk kemi asnjë kërkesë të refuzuar.	Përfunduar	S'ka
-----	------------	--	------------	---	------------	------

19.	01.04.2025	Ana Rrushi Studente, Do doja një shifër të të punësuarve në Bashkinë Kamëz të cilët punojnë në Bashkinë Kamez. Këto të dhëna duhet të jenë brenda 10 vjecarit të fundit, pra duke nisur nga 2015 deri në 2025.	09.04.2025	Përsa i përket punonjësve ndërvite ne Bashkinë Kamez (2015- 2025) Viti 2015 - 166 pozicione Viti 2016 - 171 pozicione Viti 2017 - 175 pozicione Viti 2018 - 175 pozicione Viti 2019 - 202 pozicione Viti 2020 - 280 pozicione Viti 2021 - 276 pozicione Viti 2022 - 304 pozicione Viti 2023 - 333 pozicione Viti 2024 - 436 pozicione Viti 2025 - 475 pozicione	Përfunduar	S'ka
-----	------------	--	------------	---	------------	------

20.	07.04.2025	Petrit Patuso Lutemi na dergoni ne email detyrimet vendore ndaj bashkise Kamez per vitin 2025 te shoqerise Agri Construction shpk, me Nipt K01725001F, me adrese rruga e Dibres, ish truproja e shkolles Skenderbej, Tirane	08.04.2025	Në zbatim të ligjit 9920 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë ", i ndryshuar. Bashkëlidhur gjeni Njoftim Detyrimin për subjektin tuaj .	Përfunduar	S'ka
-----	------------	---	------------	---	------------	------

21.	09.04.2025	Franko Saliasi A ka linjë të transportit publik në zonën e Bërxullit? Nëse jo, për cilat arsye? 2. Sa banorë ka në këtë zonë? 3.A ka pasur linjë të transportit publik në zonën e Bërxullit? Nëse po, për cilat arsye është hequr kjo linjë e transportit publik? 4. A ka ndonjë plan për vendosjen e transportit publik në këtë zonë? 5. Cili është ngërçi që ka lënë këtë zonë pa transport publik?	10.04.2025	Zona e Treshit në Njësinë Administrative nr. 11, Rruga "Princ Vidi" dhe rrugicat përreth kësaj rruge kryesore deri në Bërxullë, nuk janë pjesë e juridiksionit të Bashkisë Kamëz. Për këtë arsye, informacioni mbi këtë linjë dhe numrin e banorëve të kësaj zone dhe planet e zhvillimit të transportit urban nuk janë në disponimin tonë. Linja e vetme e miratuar nga Bashkia Kamëz është linja Kamëz-Laknas-Bërxullë dhe kthim.	Përfunduar	S'ka
-----	------------	--	------------	--	------------	------

22.	03.04.2025	Artan Rama Referuar shkresës në fjalë (nr. 957/1 prot., datë 13.03.2025) e përpiluar nga KDI, e cila ka ardhur për shkak të ankesës time (nr. 957 Prot., date 11.03.2025), konstatoj se autotiteti publik vijon të mos përgjigjet për pikën 3; 9 dhe 10. Dhe konkretisht, <u>Për pikën 3</u>: aktin e konstatimit të dorëzimit të shërbimit të mbetjeve	16.04.2025	Përsa i përket monitorimit në terren për zbatimin e kontratës koncesionare, nr. 1107 rep.nr 486/2 kol., datë 23. 05.2018 “Për dhënien me koncesion/PPP të shërbimit të pastrimit, grumbullimit, transportimit, seleksionimit dhe depozitimit të mbetjeve të Bashkisë Kamëz”, të lidhur nga Bashkia Kamëz me shoqëritë “ALKO IMPEX GENERAL CONSTRUCTION” SHPK. dhe “2T” SHPK). janë mbajtur proçes-verbale dhe situacione ditore e mujore për kryerjen e shërbimeve si dhe janë aplikuar ndalesa, gjoba e penaltete për punë të pakryera.	Përfunduar	S’ka
-----	------------	---	------------	--	------------	------

23.	14.04.2025	Halit Valteri A janë banorët përfitues të gjithë aplikues në fazën fillestare. A është respektuar përbërja familjare në momentin e aplikimit? A janë të depozituara në dojset e fitimit të pronësisë të parashikuara në Kodin Civil.	22.04.2025	Subjektet përfitues kanë aplikuar në zbatim të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të procesit të rindërtimit. Bashkia Kamëz për përcaktimin e subjekteve përfitues ka ngritur Komisionin e Posaçëm të Rindërtimit i cili ka qenë fuqiplotë dhe vendimarrës dhe në veprimtarinë e tij është mbështetur në aktet normative, konkretisht në Vendimin nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, si dhe në Vendimin nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”.	Përfunduar	S’ka
-----	------------	---	------------	---	------------	------

24.	21.04.2025	Depaertamenti Juridik TABI Construcion SH.P.K Subjekti ynë ka depozituar më datë 31.03.2025 në platformën zyrtare e-Albania aplikimin me “Njoftim Fillimi Punimesh”, në zbatim të lejes së ndërtimit të miratuar nga Bashkia Kamëz. Duke qenë se deri në momentin aktual nuk kemi marrë asnjë njoftim apo reagim zyrtar lidhur me këtë aplikim, ju lutemi të na vini në dispozicion informacion mbi: Gjendjen aktuale të shqyrtimit të aplikimit tonë; Afatet e parashikuara për shqyrtim dhe/ose miratim; Çdo dokumentacion shtesë që mund të kërkohet nga ana jonë për vijimin e procedurës;	29.04.2025	Në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore,të ndryshuar, Vendimit Nr. 296, Datë 28.03.2024 “Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave të institucionit të Bashkisë Kamëz”. Ju bëjmë me dije se: Nisur nga ndryshimet që janë bërë në sistemin elektronik të lejeve të ndërtimit (e-Leje) aplikimi me nr. AN310320250011 për procedurën “Njoftim Fillimi Punimesh” është në fazë shqyrtimi.	Përfunduar	S’ka
-----	------------	--	------------	---	------------	------

25.	28.04.2025	Artan Rama Ju lutem një kopje diskutimeve të mbajtura në Pallatin e Kulturës (Kamëz), në 18 mars 2025, ora 16:00, për miratimin e planit lokal të menaxhimit të mbetjeve, si dhe list prezencën e pjesëmarrjes, së bashku me të dhënat identifikuese që vetë pjesëmarrësit kanë deklaruar gjatë konsultimit të mbajtur	05.05.2025	Referuar kërkesës suaj për sqarim, iu bëjmë me dije se të dhënat që ju kërkonit në lidhje me diskutimet e realizuara mbi Planin Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane janë të publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Kamëz. https://kamza.gov.al/regjistri-elektronik-per-njoftimet-dhe-konsultimet-publike/	Përfunduar	S'ka
-----	------------	--	------------	---	------------	------

26.	29.04.2025	Englantima Fana Banorët e zonës pranë Ambulancës Paskuqan 2 - Vresht në Njësinë Administrative Paskuqan, ju drejtohem me këtë kërkesë për shtrimin e rrugës që lidh shtëpitë tona me rrugën kryesore. Aktualisht, kjo rrugë është në gjendje të mjerueshme, duke shkaktuar vështirësi të mëdha në lëvizje, veçanërisht në stinën e shirave, kur bëhet e pakalueshme për këmbësorët dhe mjetet.	10.05.2025	Ju informojmë se gjatë periudhës 2020–2024 vetëm në Njësinë e Paskuqanit kanë përfunduar rreth 70.4 km rrugë, të cilat janë investuar me standarte e parametrat e duhura. Për vitin 2025, Bashkia Kamëz ka planifikuar dhe investimin e 19 km rrugë të tjera në Njësinë Administrative Paskuqan. Rruga pranë Ambulancës Paskuqan 2 - Vresht nuk është përfshirë në listën e investimeve të projekt-buxhetit për vitin 2025, por do të jetë prioritet në buxhetin e vitit të ardhshëm	Përfunduar	S'ka
-----	------------	---	------------	---	------------	------

27.	27.05.2025	Olsi Meta Objekti yne eshte ndertuar shume me heret se nje pjese tjeter ngjitur me te, pjese qe sot eshte e legalizuar, ndersa ne jemi ende ne nje faze qe ne çdo vend normal do te ishte mbyllur prej kohesh. Te dyja pjeset ndodhen ne te njejtin objekt ndertimi, me strukture te njejte, mur dhe çati te perbashket, por vetem njera pjese ka perfituar legalizimin. Une nuk jam i fushes por me llogjike te thjeshte mendoj se ligji nuk funksionon ne kete menyre	30.05.2025	Bashkia Kamëz bën propozimet dhe shqyrtimin , ku si bllok prioritar eshte propozuar zona kadastrale prioritare 3992 Bathore dhe zona kadastrale 2066 Bathore përkatësisht lagjja 5,6 dhe 7, e cila është në përfundim të evidentimit faktik në terren, të cilat përcillen për trajtim Drejtorisë Vendore të ASHK-së Kamëz-Vorë. Eshtë propozuar Drejtorisë Vendore të ASHK-së Kamëz-Vorë vijimi i trajtimit në vazhdimësi zona kadastrale 2884 Paskuqan,3993 Paskuqan 2 dhe zona kadastrale 2066 Kamëz.	Përfunduar	S'ka
-----	------------	---	------------	--	------------	------

28.	10.06.2025	Klodiana Murataj Une drejtohem me kete kerkese per pranimin e femijes tim, Alvin Murataj i lindur me 02.04.2024, ne Cerdhen Nr.2 Diell, te Bashkise Kamez per vitin arsimore 2025-2026. Ju lutem shqyrtoni kete kerkese , duke mare parasysh deshiren e madhe dhe konsideraten qe kam per punen tuaj qe keni bere me cerdhet dhe kopshtet, Bashkangjitur do te gjeni kerkesen time. Une kam pasur edhe djalin tim te madh Aiden Murataj me perpara ne kete cerdhe dhe jam shume e kenaqur me perkushtimin dhe punen e stafit Diell, Gjithashtu theksoj qe e kam afer vendit tim te punes .	20.06.2025	Çerdhja për të cilën ju keni shprehur interes ndodhet në qendër Kamëz aty ku popullsia ka lëvizje demografike të vrullshme, si pasojë e urbanizimit të qytetit, jemi të vetëdijshëm që numri i kërkesave është shumë i lartë. Megjithatë, jemi të angazhuar për të ofruar shërbim cilësor dhe gjithëpërfshirës , prandaj në Bashkinë Kamëz përparësi në regjistrimin e fëmijëve në çerdhe u është dhënë kategori ve të familjeve në nevojë sipas VKB-së nr.42, datë 22.04.2024	Përfunduar	S'ka
-----	------------	---	------------	--	------------	------

29.	17.06.2025	Arjola Skënderi Ju lutem, a mund të më informoni për procedurën e aplikimit dhe dokumentacionin e nevojshëm të bëjmë martesë në Gjermani.	24.06.2025	Për kryerjen e procedurës kërkohen këto dokumenta të shtetasve : 1-Çertifikata e lindjes së shtetasit të huaj me vulë Apostila nga Gjermania. 2-Leja e martesës (vërtetim beqarie) po për shtetasin e huaj me vulë Apostila nga Gjermania. 3-Vërtetim banimi po me vulë Apostila nga Gjermania. 4-Fotokopje të dokumentit me foto të shtetasit të huaj. Përsa i përket shtetases shqiptare duhet kopja e Kartës së Identitetit.	Përfunduar	S'ka
-----	------------	--	------------	--	------------	------

30.	26.06.2025	Qendra “Res Publica” Sa është numri i tenderave të realizuara për periudhën Janar 2024-Qershor 2025? Kopje të listës së kontratave të lidhura për periudhën Janar 2024-Qershor 2025 ku të përfshihen të dhëna mbi operatorin ekonomik të kontraktuar, vlerën e kontratës, datën e lidhjes së kontratës, objektin etj; Kopje të dokumentacionit në lidhje me realizimin e kontratave të mësipërme.	09.07.2025	Në përgjigje të shkresës nr. 57/25 prot., datë 26.06.2025 "Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion dokumentacioni", dërguar nga qendra juaj Res Publica, bashkëngjitur ju dërgojmë informacionin e kërkuar të detajuar në tabelë.	Përfunduar	S'ka
-----	------------	---	------------	--	------------	------

31.	07.07.2025	Redaksia “Nyje.al” “Miratimin e projektit të buxhetit afatmesëm (PBA) për periudhën 2026, 2027, 2028? Shprehjen e pëlqimit në parim mbi kërkesën nr. 2945/12 prot., datë 29.05.2025 të Minis trisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit? Miratimin në parim të nisjes së procedurës për rishikimin e çmimit të biletave të transportit urban”.	18.07.2025	Referuar kërkesës suaj për informacion në lidhje me vendimet e marra në Këshillin Bashkiak Kamëz me datë 25.06.2025, ju bëjmë me dijeni se të gjitha vendimet i gjeni të publikuara në faqen zyrtare të Bashkisë sapo na vjen dhe Konfirmimi Ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë. Jemi në dispozicion për çdo paqartësi.	Përfunduar	S’ka
-----	------------	---	------------	--	------------	------

32.	06.08.2025	Besim Karaj Dëshiroj të marr numrin e kartës sime të identitetit, pasi ajo është humbur dhe më nevojitet për të përfunduar vetëdeklarimin në platformën e- Albania.	18.08.2025	Ju lutem, paraqituni pranë sportelit tek Gjendja Civile, në Bashkinë Kamëz për sqarimin e cështjes tuaj.	Përfunduar	S'ka
-----	------------	---	------------	--	------------	------

33.	01.09.2025	ENRIK ALIA Unë prej 5 vitesh punoj me përkushtim në Agna, por jeta me qira dhe shpenzimet e mëdha na kanë rënduar shumë. Ju lutem me shumë respekt, nëse ka mundësi, të na ndihmoni për mbështetje sociale ose strehim për familjen time. Çdo ndihmë do të ishte shpëtim për ne.	04.09.2025	Pasi u njohëm me kërkesën e z. Alia e kemi kontaktuar disa herë nëpërmjet numrit të telefonit të dërguar nga ana e tij, por na rezultoi i padisponueshëm. Të dhënat janë regjistruar dhe do të rikontaktohet përmes administratorit të zonës, në mënyrë që znj. Alia të paraqitet pranë sportelit dhe t'i ofrohet asistencë e nevojshme për përfshirjen në programet e strehimit social.	Përfunduar	S'ka
-----	------------	---	------------	---	------------	------

34.	12.09.2025	Erisa Kryeziu Sa hidrocentrale (HEC-e) janë ndërtuar në bashkinë tuaj në 15 vitet e fundit, prej janarit 2010 deri në gusht 2025? Sa prej këtyre hidrocentraleve janë ende në funksion? A ka projekte të reja për ndërtimin e hidrocentraleve në territorin e bashkisë suaj aktualisht?	19.09.2025	Bashkia Kamëz nuk ka në kompetenc administrimin apo menaxhimin e asnjë hidrocentali në territorin e saj.	Përfunduar	S'ka
-----	------------	---	------------	--	------------	------

35.	29.10.2025	Erisa Proko Organizata “Faktoje” A ka bashkia Kamëz nje Plan Social te miratuar dhe nese po kur eshte miratuar? 2. Sa projekte ka zbatuar apo po zbaton bashkia Kamëz nepermjet mekanizimit te Fondit Social per periudhen 2023-2025? Sa perqind te fondit te perfituar keni perdorur deri tani te ndare sipas viteve, 2023, 2024 dhe 2025? A ka aplikuar Bashkia Kamëz per te perfituar nga Fondi Social dhe a jeni shpallur fitues ne vitin 2025?	31.10.2025	Bashkia Kamëz ka Planin Social 2024-2026 i cili është miratuar në Janar të vitit 2024. Bashkia Kamëz ka aplikuar dhe përfituar fondin social në vitin 2023 i cili është planifikuar për një periudhë 36 mujore. Për të treja vitet 2023, 2024 dhe 2025 fondi është përdorur për ofrimin e shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara pranë Qendrës Multifunksional e për Fëmijët me AK. Për vitin 2023 Bashkia Kamëz ka përdorur 100% të fondit të përfituar. Për vitin 2024 Bashkia Kamëz ka përdorur 100% të fondit të përfituar. Për vitin 2025 Bashkia Kamëz ka përdorur rreth 90% të fondit të përfituar dhe deri në fund të vitit është parashikuar të	Përfunduar	S’ka
-----	------------	--	------------	--	------------	------

				përdoret në masën 100%.		
--	--	--	--	----------------------------	--	--

36.	28.10.2025	Qendra "Konsumatori Shqiptar" A është ngritur dhe funksionon pranë Bashkisë Zyra për Mbrojtjen e Konsumatorëve? Cila është struktura përkatëse e ZMK-së në institucionin tuaj? Cilat janë funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e ZMK-së ose nënpunësit përktaës?	04.11.2025	Në Bashkinë Kamëz është ngritur Sektori i Mbrojtjes për Konsumatorin, sipas vendimit nr. 01, datë 06.01.2020 "Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Kamëz". Bashkëngjitur do të gjeni dhe strukturën përkatëse të miratuar sipas vendimit të cituar. Drejtori i Drejtorisë së Mjedisit, Mbrojtjes për Konsumatorin, Kontrollit Veterinar dhe Ushqimor - Përgjegjës sektori. - Pesë specialistë veterinerë. - Dy specialistë të mbrotjes së konsumatorit. - Një teknologe ushqimore.	Përfunduar	S'ka
-----	------------	--	------------	---	------------	------